



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 362/5 prot.

Tiranë, 24.9.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Nertina Kosova
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 7.9.2018, është njoftuar vendimi nr. 43, datë 18.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim znj. Nertina Kosova, gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 43 datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit znj. Nertina Kosova është gjyqtare prej vitit 1998 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pikës 3 të Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë, pasi është një nga kandidatet për anëtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor¹.

¹ Referuar dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Nertina Kosova ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (në vijim referuar si Inspektorati), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Nertina Kosova*”², ka referuar për subjektin se:

- i. *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin³, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 Inspektorati i KLD-së, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit⁴, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (1 i tillë), Komisioni nuk ka gjetur elementë që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

3. Komisioni pas hetimit dhe vlerësimit të pavarur mbi faktet dhe rrethanat lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike dhe ato private⁵, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arritur në përfundimet si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, fillimisht nga hetimi administrativ ka rezultuar se për vitin 2006, vit në të cilin subjekti ka blerë pasurinë e paluajtshme (apartament), ky i fundit ka pasur pamjaftueshmëri financiare në shumën totale 1.847.164 lekë. Deklarimet e subjektit mbi kursimet e krijuara prej kontributit të saj, por të mbajtura prej prindërve, ka qenë në nivel deklarativ dhe jo bindëse (pika 1.10-11 e vendimit).

3.1.1 Në këto kushte, trupa gjyquese e Komisionit me vendimin nr. ***, datë ***.7.2018, ka vendosur t’i kalojë barrën e provës subjektit të rivlerësimit, bazuar në paragrafin 5⁶ të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, lidhur me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

3.1.2 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti, në përfundim ka konkluduar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

² Protokolluar pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017.

³ Shkresa e DSIK-së me nr.*** prot., datë ***.10.2017 (deklasifikuar).

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë ***.1.2017.

⁵ Gjatë hetimit administrativ nga ana e KPK-së janë administruar prova/akte nga Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, OSHEE etj.

⁶ “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Subjekti është gjendur në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur nga Inspektorati i KLD-së, analizimit dhe hetimit të 1 denoncimi nga publiku, në konsideratë edhe të propozimit të relatorit të çështjes për vlerësimin e subjektit “E aftë”, në përfundim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të lartë në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

8. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, dhe provat e administruara për këtë qëllim nga Komisioni, vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t’iu paraqitur juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi;

9.1 Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se për sa i takon vlerësimit të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjektit dhe personave të lidhur me të.

9.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk ka qenë i plotë e për rrjedhojë përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.

9.3 Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon rishikimin e vendimit nr. 43 datë 18.7.2018, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, administrimit të provave për të identifikuar mënyrën e krijimit të pasurisë/likuiditeteve, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të krijimit sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

10. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit ushtrohet për kriterin e vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

II.A Mangësitë e konstatuara, vlerësimi i Komisionerit Publik për kontrollin e kriterit të pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit

11. Vlerësimin e pasurisë, si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, e gjejmë të rregulluar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, ku realizimi i qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës për këtë kriter kontrolli, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e dy kategorive, (i) *subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur*; (ii) *subjekte që arrijnë nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë*. Kështu, nëse nga vlerësimi tërësor i provave gjatë procesit të rivlerësimit identifikohen këto dy kategori, në përfundim organi rivlerësues, sipas rastit, për qëllim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, aplikon nenin 59/1 apo nenin 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016.

12. Në vështrim të këtij detyrimi kushtetues, referuar fakteve dhe provave të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, Komisioneri Publik çmon se konkluzioni përfundimtar i Komisionit se “...subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë...”, nuk bazohet në një hetim të plotë e të gjithanshëm.

13. Subjekti i rivlerësimit znj. Nertina Kosova ka filluar të deklarojë për herë të parë interesat privatë dhe financiarë në vitin ***. Në deklaratën e saj të parë dhe deri në vitin *** konstatohet se znj. Nertina Kosova nuk ka deklaruar asnjë vlerë të kursyer gjatë viteve që ajo kish qenë në marrëdhënieve pune ***.*** (prej qershorit *** znj. Nertina Kosova ishte gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë ***). Ndërkohë, në deklaratën e saj vjetore të ***, pasqyruar edhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar në posedim/pronësi të saj një apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², ndodhur në adresën Rr. “***”, pallati “***”, ***. Kjo pasuri është shlyer nga subjekti i rivlerësimit në vitin *** për çmimin total 6.000.000 lekë dhe referuar pyetësorit të Komisionit⁷ dhe shkresës së OSHEE-së⁸, subjekti ka filluar të jetojë në këtë banesë prej shkurtit ***.

14. Për këtë pasuri, nga hetimi administrativ, fillimisht Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare në vlerë 1.847.164 lekë, në shtator të ***, shkak për të cilin bazuar në nenin D, paragrafi 5 i aneksit të Kushtetutës, subjektit i kaloi edhe barra e provës për të vërtetuar të kundërtën.

15. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kjo pasuri ende nuk është e regjistruar pranë ZVRPP-***⁹ dhe titulli i posedimit bazohet në kontratën e sipërmarrjes nr.*** kol., datë ***.9.2006, lidhur para noterit publik znj.***.***, midis subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e

⁷ Protokolluar me nr.***, datë ***.2.2018.

⁸ Sipas përgjigjes së OSHEE-së nr.*** prot., datë ***.2.2018, subjekti ka lidhur kontratë klienti më datë ***.2.2008.

⁹ Referuar shkresës së ZVRPP-së me nr.*** prot., datë ***.1.2018.

porositëses dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, vlera e dakordësuar e apartamentit prej 6.000.000 lekë është shlyer plotësisht nga subjekti në datën e lidhjes së kontratës, pra në datë ***.9.2006.

15.1 Për burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar kredinë bankare në vlerën 5.000.000 lekë, lëvruar me kontratën nr.***, datë ***.12.2005, lidhur me *** (***) dhe me garanci hipotekore,¹⁰ një pasuri në pronësi të të atit, z. *** ***. Ndërsa për diferencën nga çmimi total, shuma 1.0 milion lekë, subjekti ka deklaruar se është mbuluar nga (i) kursimet e saj ndër vite prej pagës si pedagoge (vitet ***-***); (ii) kursime nga bursa në vlerën 4.480.000 lireta/ITA nga *** (Itali/**); (iii) paga si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë *** (***-***); (iv) paga si gjyqtare në Gjykatën për Krimet e Rënda, (***-***). Gjithashtu, znj. Nertina Kosova ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit të apartamentit, kryer gjatë viteve ***-***, në vlerën totale prej 800.000 lekë, janë mbuluar nga kursimet e saj.

16. Në lidhje me saktësinë, mjaftueshmërinë e këtij deklarimi dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se disbursimi i kredisë për blerjen e kësaj pasurie është bërë në datë ***.12.2005 dhe është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit më datë ***.1.2006, pra 8 muaj para se kjo shumë të paguhej për blerjen e apartamentit në datën e lidhjes së kontratës, datë ***.9.2006.

16.1 Mbi arsyet e mbajtjes së kësaj shume *cash* jashtë sistemit bankar¹¹ për një kohë relativisht të gjatë, nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit përpara lidhjes së kontratës së sipërmarrjes të shtatorit 2006 kishte lidhur një tjetër kontratë sipërmarrjeje me kusht kreditimi, me nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë ***.12.2005, kontratë që u paraqit pranë *** (***), me qëllim lëvrimin e kredisë. Sipas kushteve të kësaj kontrate, subjekti në cilësinë e porositëses kishte porositur një apartament për çmimin 6.500.000 lekë pranë palës sipërmarrëse, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe referuar nenit 3 të kontratës, çmimi total duhet të paguhej në dy këste, ku njëri këst prej 5.000.000 lekë do të paguhej nga subjekti me anë të kredisë bankare, që duhej të derdhej në llogarinë bankare të shoqërisë dhe diferenca e mbetur, kësti tjetër në shumën 1.500.000 lekë, i ishte paguar shoqërisë “****” sh.p.k. nga subjekti i rivlerësimit, përpara redaktimit dhe nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Edhe veprimet për pagesën e kësaj shume nuk rezultojnë të jenë evidentuar si fakte nga vetë subjekti, por janë konstatuar vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

16.2 Duke qenë se kjo kontratë nuk është realizuar¹² dhe ishte paguar shuma 1.5 milionë lekë, subjekti pretendon¹³ se palët janë kthyer në gjendjen fillestare dhe shuma e paguar prej saj i është kthyer plotësisht nga sipërmarrësi, por për këtë pretendim nuk disponon asnjë mandat apo dokument provues.

16.3 Nga hetimi administrativ i Komisionit, ndër të tjera ka rezultuar se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit z. *** ***, figuron një depozitë bankare në shumën 1.900.000 lekë pranë bankës “****”, nga e cila (depozitë kjo e hapur fillimisht në vitin ***, pranë Bankës së Shqipërisë¹⁴, e padeklaruar), në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes të datës ***.9.2006, është kryer një transaksion bankar, ku z. *** *** ka tërhequr shumën 600.000 lekë, dhe sipas shpjegimeve të subjektit¹⁵, kjo shumë së bashku me shumën tjetër 400.000 lekë, marrë *cash* sërish prej tij (të atit), përbëjnë shumën 1.000.000 lekë, me qëllim plotësimin e diferencës midis çmimit të apartamentit dhe kredisë së marrë pranë ***.

¹⁰ Në kontratën e kredisë referohet kontrata hipotekore nr.***, rep. nr.*** kol., datë ***.12.2005, fakt i cili konfirmohet nga kartela e pasurisë garantuese e llojit truall, ZK nr. ***, nr. pasurie ***, ndodhur në ***.

¹¹ Referuar pyetësorit, protokolluar pranë Komisionit me nr.*** prot., datë ***.6.2018.

¹² Referuar përgjigjeve të subjektit dhe f.7 të vendimit, mosrealizimi i kontratës ka ardhur jo për shkak të kushtit, pra mosçelja e kredisë sipas nenit 9 të kontratës së sipërmarrjes, por për arsye të pretenduar nga subjekti se nuk ishte gjendur gjuha e përbashkët dhe dyshimit të saj se apartamenti i porositur mund të ishte në kushtet që ligjërisht nuk ekzistonte, pasi sipërmarrësi nuk kishte respektuar volumin ndërtimor të përcaktuar në lejen e ndërtimit.

¹³ Protokolluar pranë Komisionit me nr.***, datë ***.6.2018.

¹⁴ Referuar shkresës nr.*** prot., datë ***.1.2018, Banka e Shqipërisë konfirmon se z. *** ***, i ati i subjektit të rivlerësimit, ka investuar në datë ***.10.2003 në Bono Thesari me maturim tremujor shumën 2.000.000 lekë.

¹⁵ Mbi rezultatet e hetimit të Komisionit, protokolluar me nr.***, datë ***.7.2018.

16.4 Sipas pretendimit të subjektit, shuma e qarkulluar në dhjetor të 2005-ës (1.5 ml) është e njëjta me shumën 1.0 milion, e përdorur në shtator të 2006-ës. Kjo shumë pretendohet të jetë marrë nga subjekti i rivlerësimit të babai i saj, duke evidentuar si burim të ligjshëm depozitën në emër të z. *** ** (1.9 ml). Subjekti, për sa më lart deklaroi: “...burimi janë të ardhurat familjare, mes të cilave edhe kontributi im gjatë kohës që kam jetuar pranë familjes. Pra vërtetohet se prindërit e mi kanë pasur mundësi të krijimit të kursimeve nga kontributi i pagave të mia, të cilat m'i kanë dhënë në momentin kur më janë dashur të plotësojë çmimin e blerjes së apartamentit ku jetoj. Ndërkohë, pjesa prej 400.000 lekë është plotësuar nga gjendja cash që babi dispononte”.

16.5 Vlen të theksohet se këto rrethana, (i) kontrata e sipërmarrjes e dhjetorit 2005, pagesa e 1.5 ml. lekë dhe marrja mbrapsht e kësaj shume nga subjekti, (ii) marrja e shumës 1.0 ml. lekë nga i ati, z.***.***, nga të cilat 600.000 lekë provohen me anë të transaksionit bankar nga një (iii) depozitë me vlerë 1.900.000 lekë në emër të tij, kanë dalë vetëm nga hetimi administrativ i Komisionit, të padeklaruara nga subjekti, pavarësisht sa parashikon neni D i aneksit të Kushtetutës, nenet 30, 32/1, lidhur me pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

16.6 E pyetur nga Komisioni mbi arsyet e mosdeklarimit në vitin 2005-2006 dhe në deklaratën “Vetting” të kontributit të saj të mbajtur nga prindërit, subjekti ka deklaruar se: “Në lidhje me mosdeklarimin më parë të kontributit kam konsideruar se, meqenëse kanë qenë njëloj kthimi i kontributit tim ndër vitet që kam jetuar pranë tyre dhe në themel ato kanë pasur si burim vetëm të ardhurat e mia nga pagat e bursa (1999), (nuk kam pasur të ardhura nga qira apo ndonjë aktivitet tjetër), prezumonte që deklarimi ishte i plotë, duke iu përmbajtur dhe titullimit të tabelës së deklarimit në atë vit. duke e konsideruar që shuma e dhënë/kthyer nga prindërit ka pasur në themel si burim kontributin nga të ardhurat e mia nga pagat, e kam gjykuar në këtë mënyrë si kursime nga pagat. Sikurse kam sqaruar edhe më parë, raporti i kontributit të kthyer nga prindërit dhe pagat e atij viti kanë qenë brenda asaj shume. Ndërmjet meje dhe prindërve nuk kemi gjykuar për të përpiluar ndonjë akt noterial”.

16.7 Përballë këtyre fakteve, Komisioni pasi ka vlerësuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.0 ml. lekë, ka përfunduar hetimin duke konkluduar “... se nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer”. (f.10 e vendimit).

17. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat kushtetuese e ligjore mbi kontrollin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në vlerësim të provave të administruara, çmon se hetimi i Komisionit në evidentimin e burimit të krijimit të këtyre likuiditeteve nuk është shterues, pasi;

17.1 Së pari, subjekti pranon se shumat respektive, 1.5 ml. lekë, qarkulluar në dhjetor të 2005-ës, dhe shuma 1.0 ml. lekë, marrë nga i ati në 2006 për blerjen e apartamentit, ku një pjesë cash dhe një pjesë e tërhequr nga depozita e tij bankare prej 1.9 ml. lekë, janë pjesë e të ardhurave të kursyera nga prindërit “nga kontributet e mia nga pagat”, por hetimi i Komisionit për këtë qëllim është i paqartë dhe i mangët. Në vendim, Komisioni arsyeton se ka hetuar dhe analizuar mbi aftësinë financiare të subjektit për vlerën 1.0 ml. lekë (f.10 e vendimit), por në rezultatet e hetimit administrativ, pika 1.5 citohet “Në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës 1.000.000 lekë apo 1.500.000 lekë”. Kjo paqartësi nga ana e Komisionit në drejtim të hetimit dhe kërkimit të provave për qëllim të procesit të rivlerësimit, referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, konkretizohet në diferencën e pasqaruar prej 500.000 lekë në këtë rast, e cila sipas përfundimit të Komisionit se “subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.0 ml. lekë”, rezulton se nuk është marrë në analizë financiare.

17.2 Së dyti, përballë fakteve që, (i) subjekti qarkullon shumën 1.5 ml. lekë në 2005 të padeklaruara, (ii) për krijimin e pasurisë së saj shërben vlera 1.0 ml. lekë, marrë nga i ati, nga të cilat 600.000 kanë ardhur nga (iii) një depozitë e padekluar bankare prej 1.9 ml. lekë dhe

400.000 lekë *cash*, marrëdhënie kjo që në kuptim të neneve 3, pika 13¹⁶ dhe 32/1¹⁷ të ligjit nr. 84/2016, e kategorizon të atin si person të lidhur, (iv) faktit se të ardhurat e subjektit kanë shërbyer për krijimin e këtyre likuiditeteve nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare¹⁸, duhet të detyronin Komisionin që në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016, t'i kalonte barrën e provës subjektit për të gjitha likuiditetet e padeklaruara, të cilat kanë rezultuar nga hetimi administrativ, përfshirë këtu depozitën bankare në emër të të atit në vlerën 1.9 ml. lekë.

17.3 Duhet nënvizuar se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të pikës 13, neni 3 të ligjit nr. 84/2016, deri në qershor 2011 figuron të jetojë në familje (certifikate familjare), me atin e saj ***, nënën *** dhe vëllain ***. Në kuadër të një analize të mangët financiare të kryer nga ana e Komisionit, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me mundësitë e krijimit të kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur, duhet të evidentojmë faktin se (i) z. *** *** rezulton se nga data ***.4.1997 përfiton pension invaliditeti (shih vërtetimin e ISSH-Dega *** nr.*** prot., datë ***.10.2016), (ii) znj. *** *** (shih vërtetimin e ISSH-Dega *** nr.*** prot., datë ***.7.2018 përfiton të ardhur atë ulëta mujore deri në vitin 2010, kur i lind e drejta për përfitimin e pensionit të pleqërisë, (iii) vëllai, z. *** *** rezulton se krijon të ardhura të ligjshme pas emërimit të tij si kryetar i Degës së Policisë Ndërtimore *** më datë ***.12.2005.

17.4 Subjekti pranon se këto likuiditete kanë pasur burim krijimi kursimet familjare¹⁹ e nga të ardhurat e saj, por Komisioni nuk ka kryer asnjë analizë financiare për këtë qëllim.

17.5 *Së katërti*, mangësitë në hetimin e Komisionit në përcaktimin drejtë të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me kontrollin dhe ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, konstatohet edhe në vlerësimin dhe trajtimin e informacionit të dalë nga pasqyrat e lëvizjeve bankare të personit të lidhur me subjektin, vëllait të saj, z.*** ***. Nga dokumentacioni bankar (*shih vërtetim nr.*** prot., datë ***.6.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të bankës ****), konstatohet se në datë ***.4.2005 janë kryer dy derdhje *cash* përkatësisht 20.000 USD dhe 2.350 USD, total 22.350 USD, me përshkrim “*derdhje cash *** ****”, shuma këto të transferuara në një llogari bankare jashtë vendit²⁰. Llogaria transfertë është çelur në të njëjtën datë që është kryer transaksioni dhe është përdorur vetëm për këtë qëllim.

17.6 Hetimi i Komisionit në këtë drejtim ka munguar, megjithëse kjo transfertë (i) identifikohet me personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit, referuar provave të administruara, përfshirë edhe ato të dorëzuara nga vetë subjekti²¹, (ii) personi i lidhur z.*** *** nuk rezulton se ka pasur ndonjë burim të ligjshëm të dokumentuar për justifikimin e disponimit dhe transferimit të një shume të tillë prej 22.350 USD, si dhe (iii) kjo periudhë përkon me periudhën në të cilën subjekti vetëdeklaroi dhe pranoi që të ardhurat e saj administroheshin nën regjimin familjar të përbashkët, ku pjesëtar i familjes së vëllait ishte edhe i vëllai, vërtetuar kjo nga certifikata familjare.

18. Komisioneri Publik çmon se vlera provuese e rrethanave të mësipërme janë të mjaftueshme që të detyronin Komisionin të hetonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për shumën 22.350 USD, pasi në konsideratë sa trajtuam edhe më sipër rezultoi se “*nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare*” subjekti dhe familjarët e saj, në cilësinë e personave të lidhur, kanë disponuar apo qarkulluar likuiditete, për të cilat nuk ka asnjë sqarim financiar apo

¹⁶ “Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit... i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare...”

¹⁷ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

¹⁸ Prindërit e subjektit janë pensionistë dhe nuk rezultoi të kenë të ardhura të tjera përveç pensionit prej vitit 1997. Gjithashtu, referuar shkresës nr.*** prot., datë ***.2.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, **subjekti është ndarë nga trangu familjar i origjinës në maj të 2011-ës.**

¹⁹ Me shkresën nr.*** prot., datë ***.10.2016, ISSH *** konfirmon se i ati i subjektit përfiton pension invaliditeti nga data ***.4.1997 e në vazhdim, si dhe shkresa nr. *** prot., datë ***.7.2018, konfirmon për të emën e subjektit, znj. ***. *** pagat neto nga DAR ***.

²⁰ Nga përshkrimi në statement rezultoi se pagesa është kaluar në një llogari tjetër bankare jashtë vendit nëpërmjet ***

²¹ Vërtetimi i ISSH-së për punëdhënësin Policia e Ndërtimit ***-***, për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, që i përket shtetasit *** ***, për periudhën ***.11.2005 deri më ***.12.2007.

pasqyrim në arsyetimin e Komisionit, nëse për to është hetuar dhe nëse kanë ato burim të ligjshëm, kërkesë kjo e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

18.1 Si rezultat i këtij arsyetimi, në vlerësimin e Komisionerit Publik, përfundimi i vendimit të Komisionit, se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, referuar nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk bazohet në një hetim të plotë që do të bënte të mundur, që bazuar në prova dhe akte të tjera, të konstatohej burimi i ligjshëm i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit. Niveli i besueshëm për vlerësimin e pasurisë së subjektit në këtë rast shoqërohet me paqartësi dhe pikëpyetje, të cilat nuk justifikojnë konfirmimin në detyrë, pasi nga arsyetimi në vendimin e Komisionit rezulton se ai është ndalur vetëm në vlerësimin mbi aftësinë financiare të subjektit për shumën 1.0 ml, pa konsideruar likuiditetet e tjera të personave të lidhur me të, babai dhe i vëllai.

18.2 Këta të fundit, për qëllime të procesit të rivlerësimit, cilësohen si persona të lidhur në kuptim kjo të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pranuar *de facto* edhe në arsyetimin e Komisionit kur shprehet se “depozita bankare dhe më tej edhe veprimet bankare për llogari të subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë marrëdhënien e posaçme familjare dhe kontributin e dhënë në blerjen e pasurisë... si dhe veprimet bankare, vërtetimet e punësimeve të anëtarëve të familjes, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit... vërtetojnë qartazi marrëdhënien e përbashkët familjare, mundësinë e krijimit të të ardhurave ...” (f. 9, pika 1.13 e vendimit) por të pa cilësuar, hetuar dhe vlerësuar *de jure* si të tillë, për qëllim kjo të kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të likuiditeteve të qarkulluara nga familja e subjektit (depozita, bono thesari, *cash* apo transferta bankare).

18.3 Duke vepruar në këtë mënyrë, Komisioni nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues, përcaktuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, pra identifikimi i atyre subjekteve që kanë deklaruar apo jo, saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me të dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm i pasurisë apo detyrimin e përcaktuar në nenin 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, ku në çdo rast kërkon dokumente justifikuese mbi vërtetësinë e deklarimeve dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

18.4 Marrëdhënien e posaçme familjare dhe kontributi i përbashkët në krijimin e të ardhurave në rastin konkret, Komisioni duhet ta adresonte dhe hetonte nën regjimin ligjor të personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur, për sa kohë nga kjo marrëdhënie shfaqet interesi pasuror i subjektit të rivlerësimit, produktet e të cilit, duhet të justifikohen ligjërisht gjatë procesit të rivlerësimit.

18.5 Nën dritën e këtij detyrimi, koncepti i personave të lidhur, haset në nenin D të aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila për nga niveli hierarkik i normave, nuk mund të jetë e natyrës shteruese siç mund të jenë ato ligjore, që derivojnë prej saj. Kështu ligji nr. 84/2016, në pikat 13 dhe 14 të nenit 3 të tij, përcakton më gjerë konceptet e kategorisë “*personat e lidhur*²²” dhe “*personat e tjerë të lidhur*”, ku i pari specifikon personat fizikë, të afërt familjarë dhe të lidhur me subjektin, në kufijtë e personave të përmendur në certifikatën familjare të subjektit, ndërsa në rrethin e “*personave të tjerë të lidhur*” rrethi zgjerohet duke përfshirë edhe personat juridikë (veç atyre fizikë) të cilët kanë apo kanë pasur lidhje interesi me subjektin, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

18.6 Nga leximi literal i këtyre dispozitave, kuptojmë se e përbashkëta e tyre për qëllim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, referuar edhe nenit 32/1 (personat e lidhur) dhe 32/4 (personat e lidhur ose personat e tjerë të lidhur) të ligjit nr. 84/2016, është se kur kjo kategori personash shfaqet apo manifestohet në interesat dhe marrëdhëniet pasurore të subjektit, ata janë njësoj

²² Si referencë, ky koncept ka gjetur rregullim edhe më parë në legjislacionin tonë të brendshëm, ku sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, në pikën 4 të nenit 2 (shfuqizuar më pas nga neni 50 i ligjit 9475/2006) përcaktonte si person të lidhur, të gjithë personat fizikë ose juridikë, të cilët nga kërkimet administrative rezultojnë të kenë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim, me njërin nga format e përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu edhe ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 përcakton se “*Person i lidhur me një zyrtar*”, është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin” (në interesat privatë përfshihet dhe neni 5/1/dh, ... interesa private që burojnë nga marrëdhënie familjare dhe bashkëjetese).

përgjegjës për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive të deklaruara apo dala nga hetimi administrativ i organit rivlerësues, pasi edhe në këtë mënyrë merr vlerë qëllimi i përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës. Nëse do të veprohej ndryshe, potencialisht krijohen hapësirat ligjore që subjekti i rivlerësuar dhe konfirmuar në detyrë, do vijonte të mos deklaronte saktësisht e mjaftueshmërisht interesat e tij pasuror e njëkohësisht të gëzonte pasuri/likuiditete të pa kontrolluara për ligjshmërinë e tyre nga personat e lidhur me të.

18.7 Mund të themi se situatë e ngjashme paraqitet edhe marrëdhënia e huasë së personit të lidhur, babait të subjektit me shtetasin ***,***, trajtuar në vijim.

A.2 Huaja e marrë nga i ati i subjektit, z. *,*** ndaj shtetasit z. ***,*****

19. Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar gjithashtu se personi i lidhur, i ati i subjektit të rivlerësimit me anë të kontratës noteriale të huasë nr.***, rep. dhe nr.***, kol. të datës ***,7.2011, ka marrë hua nga shtetasi ***,*** shumën 7.000.000 lekë, pa interes dhe me detyrim kthimi në datë **,7.2021, me përcaktimin se edhe nëse kjo shumë nuk kthehet brenda kësaj date, nuk do të aplikohet asnjë normë interesi, deri në shlyerjen totale të shumës.

19.1 Sipas kësaj kontrate, e cila për nga kushtet i afrohet më tepër një kontrate dhurimi, shuma është marrë në dy pjesë, ku paraprakisht 3.000.000 lekë janë dhënë *cash* dhe 4.000.000 lekë janë kaluar nëpërmjet transfertës bankare në datën e lidhjes së kontratës, datë ***,07.2011.

19.2 E pyetur nga Komisioni mbi këtë marrëdhënie huaje të të atit, subjekti ka deklaruar²³ se qëllimi i saj ka qenë blerja e një njësie shërbimi, pronë e shtetasit ***,*** (kunati i babait) por që nuk u realizua për shkak se trualli dhe njësia ishte vendosur si kolateral pranë “****” nga shitësi. Subjekti deklaroi gjithashtu, se nga kjo marrëdhënie e babait me kunatin e tij, gjatë periudhës 2012-2014, nga huaja e marrë i ati ka shpenzuar “400.000 lekë për shpenzime administrative dhe rreth 1,000,050 lekë i ka shpenzuar në kohë dhe për arsye të ndryshme” dhe “shuma prej 5,600,000 lekë administrohet nga i ati”.

20. Lidhur me vërtetësinë edhe të këtij deklarimi nga ana e subjektit dhe përdorimit të shumës së marrë hua, Komisioneri Publik çmon se ai nuk është i saktë.

20.1 Nga aktet e administruara, konstatojmë se në datë ***,07.2011 është xhiruar shuma prej 4.000.000 lekë nga huadhënësi ***,*** në llogarinë rrjedhëse të huamarrësit ***,***, dhe fill pas një muaji, në datë ***,08.2011, huamarrësi investon në Bono Thesari me maturim një vjeçar shumën 4.000.000 lekë dhe jo për qëllim të blerjes së njësisë së shërbimit. Gjithashtu referuar provave të dorëzuara nga vetë subjekti, kontrata hipotekore nr.***, rep. dhe kol. ***, kol ndaj pronës së ***,***, daton prej ***,09.2007, fakt i cili tregon se huamarrësi ka pasur ose mundësisht duhet të kishte informacion mbi bllokimin e kësaj prone në favor të “****”, informacion që mund ta merrte përpara se të hynte në një marrëdhënie huaje për këtë qëllim.

20.2 Në vlerësim të Komisionerit Publik mbetet e paqartë gjithashtu, pasi Komisioni nuk ka hetuar në këtë drejtim, se kur i ka kaluar pagesa e parë e huasë të atit të subjektit. Kontrata e huasë shprehet qartë se “nga vlera 7.0 ml. është dhënë paraprakisht në *cash*, vlera 3.0 ml lekë..”, pra para korrikut 2011, ndërkohë nga përgjigjet e subjektit²⁴ rreth derdhjes në llogarinë bankare të të atit në datë ***,11.2011 i shumës 3.300.000 lekë, (derdhur nga ai vet) me përshkrim “të ardhura nga biznesi”, subjekti shprehet se kjo shumë është pjesë nga huaja e marrë prej 7.0 ml. lekë, pra pjesa 3.0 ml. lekë dhe pjesa tjetër prej 270.000 lekë, është interesi i tërhequr më datë ***,08.2011 nga bonot e thesarit të Bankës së Shqipërisë. Vlen të theksohet se edhe në këtë rast, i ati i subjektit ka investuar shumën 3.270.000 lekë në Bono Thesari pranë ***, në datë ***,12.2011²⁵, fakt i cili nuk korrespondon me qëllimin e deklaruar të huasë për blerjen e njësisë së shërbimit apo kryerjen e shpenzimeve administrative prej tij.

20.3 Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni ka kryer hetim mbi mundësinë financiare të dhënies së huasë nga shtetasi ***,***, fakt ky i cili nuk gjen asnjë pasqyrim në

²³ Protokolluar me nr.***, datë ***,3.2018, ku ka bashkëlidhur edhe dokumentacion provues, si kontratë hipotekore dhe vërtetim nga dokumenti hipotekor për pronën e shtetasit z. ***,***.

²⁴ Protokolluar pranë Komisionit me nr.***, datë ***,2.2018.

²⁵ Referuar vërtetimit nr. prot. ***, datë ***,2.2018, përcjellë nga ***,

vendim, dhe QKB me shkresën nr. *** prot., datë ***.03.2018, ka konfirmuar se shtetasi ***.*** është ortak në disa shoqëri me pjesëmarrje në përqindje në kuota të ndryshme, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividend apo të ketë realizuar fitim deri në vitin 2011.

A.3 Likuiditete të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të

21. Komisioneri Publik vlerëson se në një panoramë të përgjithshme, një hetim jo i plotë nga ana e Komisionit konstatohet ndaj këtyre vlerave të likuiditeteve, që kanë rezultuar ndër vite, në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të:

i. **Në deklaratën vjetore** (referuar në vijim si DV) **2003**, subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* apo në llogari bankare. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton së në këtë vit, i ati i subjektit ka depozituar në bono thesari shumën 2.000.000 lekë dhe ka përfutur interesa 37.446 lekë, pra gjithsej likuiditete të pahetuar në emër të të atit të subjektit në këtë vit janë në shumën **2.037.446 lekë**.

ii. **Në DV 2004**, subjekti ka deklaruar gjendje në bankë shumën 200.000 lekë me 50% pjesë takuese. Nga verifikimi i llogarive bankare të kësaj periudhe rezulton se:

- Subjekti ka një llogari bankare dy emërore me të atin, në shumën 300.000 lekë, pra subjekti duhej të deklaronte të paktën 150.000 lekë si pjesë takuese;
- I ati i subjektit në dhjetor 2004, ka gjendje në llogarinë e depozitës pranë *** shumën 352.864 lekë;
- I ati i subjektit ka gjendje në llogarinë “Bono thesari” në shumën 1.900.000 lekë pranë ***;
- Janë përfutur interesa bankarë në shumën 184.699 lekë;
- Pra, likuiditete të pahetuara në fund të vitit 2004, janë gjithsej **2.737.552 lekë**.

iii. **Në DV 2005**, subjekti ka deklaruar gjendje në bankë 200.000 lekë me 50% pjesë takuese si edhe ka deklaruar gjendje në llogari, kredinë në shumën 5.000.000 lekë nga ***. Gjendja faktike e likuiditeteve të pahetuara për këtë periudhë është:

- Gjendje në llogarinë dy emërore (subjekti dhe i ati) shuma 412.712 lekë, (***);
- Gjendje në llogarinë e depozitës së të atit në shumën 365.735 lekë. (***).
- Gjendje në llogarinë e bonove të thesarit të të atit, në datë ***.11.2004 gjendja ka qenë 2.100.000 lekë, dhe pasi ka tërhequr 200.000 lekë, gjendja në fund të vitit mbetet 1.900.000 lekë (***);
- Të ardhura të padeklaruara nga interesat e depozitave dhe bonove të thesarit të të atit, përkatësisht 14.767 lekë dhe 58.977 lekë, pra gjithsej 73.744 lekë;
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 23.210 lekë, (***);
- **Likuiditete** të pahetuara në fund të vitit 2005, janë gjithsej **2.775.401 lekë**.

iv. **Në DV 2006**, subjekti ka deklaruar kursime nga paga 400.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, gjendja faktike në bankë dhe e pahetuar është si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën 268.958 lekë (***).
- Gjendje në llogarinë dy emërore (Nertina ose ***), shuma 303.471 lekë (***).
- Gjendje në llogarinë e bonove të thesarit të të atit është (800.000 lekë+300.000 lekë) gjithsej 1.100.000 lekë pranë ***.
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 130.725 lekë (***).
- Të ardhura i ati nga interesat e depozitave dhe bonove të thesarit përafërsisht 637 lekë.
- **Likuiditete** të pahetuara për vitin 2006, janë **1.803.791 lekë**.

v. **Në DV 2007**, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 500.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, gjendja paraqitet si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën -24,874 lekë (***).

- Gjendje në llogarinë dy emërore (Nertina ose ***) shuma 303.795 lekë (***)
- Të ardhura i ati nga interesat e depozitave dhe bonove të thesarit përafërsisht 41.760 lekë.
- Gjendje në llogarinë e bonove të thesarit të të atit është (800.000 lekë+300.000 lekë) gjithsej 1.100.000 lekë pranë ***.
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 122.517 lekë (***)
- Të ardhura i ati nga interesat e depozitave dhe bonove të thesarit përafërsisht 43.210 lekë.
- **Likuiditete** të pahetuara për vitin 2007, janë në shumën **1.544.648** lekë.

vi. **Në DV 2008**, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 300.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatohet se në llogarinë e depozitës së subjektit pranë *** gjendet shuma 300.000 lekë, por nuk janë hetuar llogaritë si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën 80.239 lekë (***)
- Gjendje në llogarinë bono thesari të subjektit në shumën 300.000 lekë (***)
- Pakësuar gjendja në llogarinë dyemërore (subjekti+i ati) shuma 0 lekë (***)
- Gjendja në llogarinë e bonove të thesarit të të atit, shumat (800.000 lekë+300.000 lekë) gjithsej 1.100.000 lekë, pranë ***.
- Të ardhura nga Interesat e bonove të thesarit, përafërsisht 41.760 lekë.
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 197.810 lekë (***)
- **Likuiditete** të pahetuara për vitin 2008, gjithsej janë në shumën **1.544.648** lekë.

vii. **Në DV 2009**, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 400.000 lekë, të cilat gjenden në depozitën e subjektit pranë ***. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar gjendja faktike në bankë e pahetuar është si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën 23.205 lekë (***)
- Gjendje në llogarinë bono thesari të subjektit në shumën 500.000 lekë, veprimet janë kryer nëpërmjet ***, në datë ***.09.2009.
- Gjendja në llogarinë e bonove të thesarit të të atit, në shumat (800.000 lekë+300.000 lekë) gjithsej 1.100.000 lekë, pranë ***.
- Gjendja në llogarinë depozitë e të atit në shumën 400.000 lekë, paraqitet si llogari depozite me afat, depozituar CASH në datë ***.12.2009 pranë ***.
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 269.206 lekë (***)
- Të ardhurat e të atit nga interesat e bonove të thesarit, përafërsisht 50.400 lekë.
- **Likuiditete** të pahetuara për vitin 2009, gjithsej janë **2.342.811** lekë.

viii. **Në DV 2010**, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 500.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar në dispozicion, gjendja faktike në bankë është si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën 126.158 lekë (***)
- Gjendje në llogarinë bono thesari të subjektit në shumën 700.000 lekë, veprimet janë kryer nëpërmjet ***, në datë ***.8.2010.
- Gjendja në llogarinë depozite e të atit në shumën totale 2.000.000 lekë nga të cilat 400.000 lekë janë rinovuar depozitat, depozituar CASH shuma 850.000 lekë në datë ***.04.2010; depozituar CASH shuma 750.000 lekë në datë ***.5.2010, pra gjendja në llogari depozitë me afat në fund të vitit 2010 është gjithsej 2.000.000 lekë. (***)
- Të ardhurat nga i ati nga interesat e bonove të thesarit dhe depozitave, përafërsisht 80.400 lekë.
- **Likuiditete** të pahetuara për vitin 2010, gjithsej janë **2.933.603** lekë.

ix. Në DV 2011, subjekti ka deklaruar “Pakësim kursime CASH të mbartura deri në datë ***.12.2010, për blerje Bono Thesari, me afat deri në ***.03.2012”, shuma e deklaruar 800.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar dhe gjendja e likuiditeteve të pahetuara në bankë paraqitet si më poshtë:

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të subjektit në shumën 22.633 lekë (***).
- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të nënës së subjektit 0 lekë (***).
- Gjatë vitit 2011, i ati i subjektit ka depozituar pranë ***, shumat 400.000 lekë dhe 1,050,000 lekë, përkatësisht në ***.01.2011 dhe ***.05.2011 në depozita 12 mujore, gjithsej 1.450.000 lekë.
- Gjendja në llogarinë e bonove të thesarit të të atit në shumën 7.300.000 lekë, të depozituara nga i ati, nëpërmjet *** përkatësisht shuma 4.000.000 lekë dhe 3.300.000 lekë me përshkrim “të ardhura nga biznesi”.
- Të ardhurat e të atit nga interesat e bonove të thesarit depozitave përafërsisht 370.190 lekë.
- Në maj të vitit 2011, subjekti shkëputet nga trangu familjar dhe paraqitet e vetme në certifikatë, por kjo nuk e përjashton nga detyrimi i deklarimit të interesave pasurorë deri në momentin e shkëputjes.

21.1 Sa më sipër, për periudhën 2003-2011, nuk janë hetuar gjendjet e likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve të saj/personave të lidhur, të gjendura në llogari bankare. Në tabelën e mëposhtme ato paraqiten në mënyrë të përmbledhur.

| Fundi i vitit | Likuiditete të deklaruara nga SR | Llogaria rrjedhës SR | Llogari B. Thesari (SR) | Llogaria përbash. SR+i ati | Llogari depozitë (i ati i SR) | Llogari B. Thesari dhe kursimi-i ati | Llogari rrjedhëse nëna e SR | Interesa bankare | Shuma e likuiditeteve të pahetuara ²⁶ |
|---------------|----------------------------------|----------------------|-------------------------|----------------------------|-------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|------------------|--|
| 1 | 2 ²⁷ | 3 ²⁸ | 4 ²⁹ | 5 ³⁰ | 6 | 7 | 8 ³¹ | 9 ³² | 10 |
| 2003 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2.000.000 ³³ | 0 | 37.446 | 2.037.446 |
| 2004 | 200.000 | 0 | 0 | 300.000 | 353.364 ³⁴ | 1.900.000 ³⁵ | 0 | 184.688 | 2.737.052 |
| 2005 | 200.000 | 0 | 0 | 412.712 | 365.735 ³⁶ | 1.900.000 ³⁷ | 23.210 | 73.744 | 2.775.401 |
| 2006 | 400.000 | 268.958 | 0 | 303.471 | 0 | 1.100.000 ³⁸ | 130.725 | 637 | 1.803.791 |
| 2007 | 500.000 | (24.874) | 0 | 303.795 | 0 | 1.100.000 ³⁹ | 122.517 | 43.210 | 1.544.648 |
| 2008 | 300.000 | 80.239 | 300.000 | 0 | 0 | 1.100.000 ⁴⁰ | 197.810 | 41.760 | 1.719.809 |
| 2009 | 400.000 | 23.205 | 500.000 | 0 | 400.000 ⁴¹ | 1.500.000 ⁴² | 269.206 | 50.400 | 2.842.811 |

²⁶ Në këtë kolonë, në vitin 2011 përfshihet dhe huaja e marrë nga i ati i znj. Nertina Kosova nga z. ***.*** në vlerën 7.000.000 lekë).

²⁷ Kolona 2, referon deklarinimet që subjekti i rivlerësimit ka kryer në deklaratat vjetore (DV) në vitet përkatëse, pra nga viti 2003 deri në 2011.

²⁸ Referuar të dhënave të llogarisë bankare të SR dërguar nga ***, Vërtetim “Mbi produktet bankare”, datë ***/01/2017, *** PM, për periudhën 2005 – 20016, NRP e klientit ***.

²⁹ Referuar të dhënave të llogarisë bankare dërguar nga ***, gjendet në pasqyrat e lëvizjeve bankare të llogarisë nr. *** në emër të Nertina Kosova ose *** ***, shkresa protokolluar në KPK Nr. *** datë ***.2.2018.

³⁰ Referuar të dhënave të llogarisë bankare dërguar nga ***, gjendet në pasqyrat e lëvizjeve bankare të llogarisë *** në emër të Nertina Kosova ose *** ***, shkresa protokolluar në KPK nr. *** datë ***.2.2018.

³¹ Referuar pasqyrave të lëvizjeve bankare të ardhura nga ***, në format elektronik-përgjigje *** CD.

³² Janë llogaritur vetëm interesat të cilat figurojnë në pasqyrat e lëvizjeve bankare që kemi në dispozicion.

³³ Referuar shkresës së Bankës së Shqipërisë dërguar në KPK, protokolluar me nr. *** prot., datë ***.1.2018, dhe informacionit bashkëlidhur.

³⁴ Referuar lëvizjeve të llogarive bankare të *** të ***, ***, nr. *** (dok administruar).

³⁵ Bazuar në pasqyrat e lëvizjeve bankare të *** ***, dërguar në format elektronik nga ***, datë ***.1.2018; *** AM, si edhe konfirmuar nga info. i BSH, protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë ***.1.2018.

³⁶ Referuar lëvizjeve të llogarive bankare të *** të ***, ***, nr. *** (dok administruar).

³⁷ Bazuar në pasqyrat e lëvizjeve bankare të *** ***, dërguar në format elektronik nga ***, datë ***.1.2018; *** AM, si dhe konfirmuar nga info. i BSH protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë ***.1.2018.

³⁸ Banka ***, Gjendje në llogari kursimi 800.000 lekë+300.000 gjendje në llogari mbështetëse = gjithsej 1.100.000 lekë, bazuar në përgjigjen e *** shkresa protokolluar në KPK nr. *** prot, datë ***.1.2018 dhe informacioni bashkëlidhur.

³⁹ Banka ***, Gjendje në llogari kursimi 800.000 lekë+300.000 gjendje në llogari mbështetëse=gjithsej 1.100.000 lekë, bazuar në përgjigjen e *** shkresa protokolluar në KPK nr. *** prot., datë ***.01.2018 dhe informacioni bashkëlidhur.

⁴⁰ Banka ***, Gjendje në llogari kursimi 800.000 lekë+700.000 gjendje në llogari mbështetëse=gjithsej 1.500.000 lekë, bazuar në përgjigjen e *** shkresa protokolluar në KPK nr. *** prot, datë ***.01.2018 dhe informacioni bashkëlidhur.

⁴¹ Refeuar shkresës së ***, nr. Prot. *** datë ***.01.2018, protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë ***.1.2017 dhe lëvizjeve të llogarisë bashkëlidhur shkresës.

⁴² Banka ***, Gjendje në llogari kursimi 800.000 lekë+300.000 gjendje në llogari mbështetëse=gjithsej 1.100.000 lekë, bazuar në përgjigjen e *** shkresa protokolluar në KPK nr. *** prot., datë ***.1.2018 dhe informacioni bashkëlidhur.

| | | | | | | | | | |
|------|-----------|----------|---------|---|-------------------------|-------------------------|----|---------|-----------|
| 2010 | 500.000 | 126.158 | 700.000 | 0 | 2.000.000 ⁴³ | 0 | 45 | 107.400 | 2.933.603 |
| 2011 | (800.000) | (22.633) | 0 | 0 | 1.450.000 ⁴⁴ | 7.300.000 ⁴⁵ | 0 | 370.199 | 9.097.566 |

21.2 Pjesë e hetimit të munguar nga ana e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të likuiditeteve bankare, për efekt të tabelës së mësipërme, duhet të konsiderohet dhe transferta bankare në vlerën prej 22.350 USD, e kryer nga ana e vëllait të subjektit të rivlerësimit, në datë 06.04.2005.

22. Çështje të tjera

22.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen përkatëse, rezulton se Drejtorja Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor ***, me shkresën nr. *** prot. datë ***.4.2018, ka informuar Komisionin se i ati i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targë ***, si dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi mjetin më targë ***, i cili ka dalë nga qarkullimi në datë ***.7.2010⁴⁶.

22.2 Mjeti më targë *** është përdorur dhe poseduar gjatë periudhës që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për ta deklaruar, blerë nga i ati në vlerën 880.000 lekë në vitin 2000, disponuar deri në vitin 2008, ku dhe vetë subjekti ka pasur policë sigurimi që ka mbuluar periudhat nga ***.4.2007-***.4.2008 dhe ***.4.2008-***.4.2009.

22.3 Edhe në këtë rast, Komisioni nuk ka hetuar mbi shkaqet e mosdeklarimit dhe mundësitë financiare të të atit të subjektit, si person i lidhur për të investuar në blerjen e automjetit.

III. Kërkimi i ankimit

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, D, Ç dhe F/3 të Aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve, nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenin 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt;

25. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

26. Referuar pikës 3, të nenit F të aneksit të Kushtetutës, ku sanksionohet se: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të

⁴³ Referuar shkresës së ***, nr. Prot. ***, datë ***.1.2018, protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë ***.1.2017 dhe lëvizjeve të llogarisë bashkëlidhur shkresës.

⁴⁴ Referuar shkresës përgjigje të *** dërguar KPK, protokolluar me nr. *** prot., datë ***.1.2018 dhe informacionit bashkëlidhur.

⁴⁵ Referuar shkresës së Bankës së Shqipërisë dërguar në KPK, protokolluar me nr. *** prot., datë ***.1.2018, dhe informacionit bashkëlidhur dhe vërtetimit nr. prot. ***, datë ***.2.2018 të degës së ***.

⁴⁶ Referohu dokumentacionit në dosje të Komisionit. Komisioni nuk rezulton të ketë kërkuar informacion mbi faktin nëse i vëllai i subjektit ka në pronësi apo përdorim mjete.

rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim...”;

27. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe vetëm pasi të ketë kryer vetë Kolegji një hetim dhe vlerësim mbi burimin e ligjshëm, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë/likuiditetet e subjektit të rivlerësimit znj. Nertina Kosova dhe personave të lidhur me të, në zbatim të nenit 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 18.7.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA